



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:097014
Datë: 13.08.2024
Numri i dokumentit: 06043499

2024:073920

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.S me adresë në fsh. M. Ferizaj, me numër personal, të cilën e përfaqëson S.R, avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson S.V nga Ferizaj, për shkak të anulimit të njoftimit nr. 344/2 i dt. 20.07.2020, kthimin në vendin e punës dhe kompensimit të pagave, vlera e kontestit 20286,64 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 23.07.2024 në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, kurse më datë 13.08.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëses A.S me adresë në fsh. M-K.Ferizaj, me numër personal, me të cilën ka kërkuar që të "miratohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses ashtu që anulohet njoftimi me numër 342/2 të datës 20.07.2020, i lëshuar nga e paditura Komuna Ferizaj-Drejtoria e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "I.Q." në ..., detyrohet e paditura që paditësen ta kthejë në vendin e punës në përputhje me kontratën ose ta sistemoj në ndonjë shkollë tjetër në Ferizaj në përputhje me kontratën, shkollimin si dhe fondin e orëve, detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e pagave për periudhën kohore prej datës 01.09.2020 deri më 18.07.2024 në vlerën 20286,64 euro (njëzetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e katër cent), si dhe për çdo muaj nga 435.4€ deri në kthimin në vendin e punës, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 945,00 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Rrjedha e çështjes

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr.1296/20, të dt. 30.03.2021, I. e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses A.S nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit si e bazuar, II. detyrohet e paditura që paditësen ta kthejë në vendin e saj të punës si mësimdhënëse e edukatës figurative apo në ndonjë lëndë ekuivalente në Shkollën Filllore e Mesme të Ulët "I.Q." në fsh.... - K.Ferizaj, ose në ndonjë nga shkollat tjera në territorin e Komunës së Ferizajt në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, III. detyrohet e paditura që në emër të pagesës së pagave mujore, si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për periudhën kohore 20.07.2020-01.03.2021, në emër të pagave neto t'i paguaj paditëses shumën prej 2612.14€ në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, IV. detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj paditëses shumën prej 495,00€, në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, V. refuzohen të pabazuara kërkesëpadia e paditëses me të cilën ka kërkuar që të kompensohet për çdo muaj nga 435.40€ përtej muajit shkurt 2021 deri në kthimin në vend të punës dhe kërkesa për kamatë ligjore prej 8%, VI. konsiderohet e tërhequr padia e paditëses në lidhje me kërkesën e saj për anulimin e konkursit me nr. 401 të dt. 13.07.2020 për mësimdhënëse të edukatës figurative në SHFMU I. Q.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin AC.nr.3836/21, të dt. 24.02.2024, e ka aprovuar si të themeltë ankesën e të autorizuarës së paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, PRISHET aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1296/20, të dt. 30.03.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja përmes të autorizuarit të saj av. S.R nga Ferizaj, ka paraqitur padi në këtë gjykatë më dt. 14.08.2020, me objekt kontesti kthimin në vendin e punës dhe kompensimit të pagave. Në riprocedurë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka deklaruar se edhe më tutje mbetemi pranë padisë, kërkesëpadisë, theksimeve në seanca, tani edhe pas administrimit të provave është vërtetuar gjendja faktike dhe juridike se e paditura ka bërë shkëputjen e marrëdhënies së punës pa asnjë procedurë të rregullt si dhe në kundërshtim me kontratën e punës dhe Ligjin e Punës. Paditësja ishte punësuar tek e

paditura në vendin e punës mësimdhënëse lëndore – art figurativ në SHFMU I. Q në bazë të kontratës së punës. Paditësja këtë pozitë e ka ushtruar që nga viti 2016, pra paditësja ka mbi 4 vite përvojë pune në këtë pozitë. Gjatë kësaj kohe të punës është vërtetuar se paditësja asnjëherë nuk kishte marr asnjë vërejtje për punën e saj përkundrazi paditësja kishte pranuar licencën për mësimdhënëse. Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se e paditura asnjëherë nuk e ka njoftuar paditësen për shkaqet e ndërprerjes së kontratës së punës e as që e kishte paraqitur ndonjë vërejtje apo arsyeje për këtë veprim, por në mënyrë arbitrare e paditura ishte njoftuar nga drejtori i shkollës se nuk je më mësimdhënëse në shkollë dhe kishte marr njoftimin nga drejtorja, pa asnjë procedurë paraprake, pra pa një njoftim lidhur me shkeljet e detyrave të punës apo se çfarë ka ndikuar për shkëputjen e kësaj marrëdhënie pune. Për më tepër njoftimi nr. 401/2 lidhur me procedurat e inspektoratit të punës është totalisht i pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 2098/22, i dt. 16.12.2022. Ka shtuar se në bazë të aktvendimit të gjykatës së apelit është rekomanduar që të shqyrtohet ligjshmëria apo kërkesa lidhur me anulimin ose ndryshimin e njoftimit me numër 344/2, dt.20.07.2020 me të cilin njoftim paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës, andaj në kërkesëpadi të këtij shqyrtimi ka kërkuar nga gjykata që përveç kërkesave tjera të bëhet edhe anulimi i vendimit meqë i njëjti është i paligjshëm, duke marr parasysh se nuk përmbush kërkesat për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në bazë të Ligjit të punës nga neni 67,70, 73 të Ligjit të punës. Duke marr parasysh se kjo çështje është kthyer në rigjykim dhe rivendosje, ka ritheksuar se paditësja është punësuar tek e paditura në vendin e punës si mësimdhënëse e lëndës art figurativ fillimisht në vitin 2016 e më pas me kontratën e vitit 2017 e në fund me 1 nëntor 2019, ka nënshkruar kontratën me afat të pacaktuar e dt. 1.10.2019 me numër protokollit 271/2 e në këtë pozitë e njëjta kishte mbi 4 vite përvojë pune, dhe kontratën e punës me afat të pacaktuar. Duke ritheksuar se e njëjta kishte vazhduar punën dhe asnjëherë nga e paditura nuk kishte marr ndonjë vërejtje apo te ishte marr ndonjë masë tjetër lidhur me punën apo për punën e saj. Përveç se me dt. 20 korrik 2020, drejtori i shkollës me anë të njoftimit me numër protokollit 344/2, i ndërprente marrëdhënien e punës paditëses, me këtë njoftim i cili përmban 3 rreshta theksohet se “njoftohet paditësja se me dt. 13.07.2020 me numër protokollit është ndërpre marrëdhënia e punës në shkollën tone, të lartpërmendurës po me këtë datë i është shpallur vendi i punës”. Kjo ishte i tërë njoftimi për shkaqet e marrëdhënies së punës së paditëses, edhe pas kësaj paditësja ka parashtruar kërkesa drejtorisë dhe ankesë për shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga të cilat ishte refuzuar me njoftimin se vendi yt i punës është shpallur me konkursin e ri, duke mos i dhënë asnjë sqarim, andaj duke marr parasysh Ligjin e punës se fillimisht e njëjta kishte kontratë si dhe kontratën kolektive të arsimit në përcaktimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së

punës, duhet të ekzistojnë dhe të përmbushen kushtet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga neni 70,71,72 të Ligjit të Punës si dhe të përcaktohet nëse ka shkelje të detyrave të punës dhe të përcaktohet se cilat shkelje do të ishin, e meqë asnjëra nga këto nuk është përmbushur kuptojmë që një njoftim i tillë është i paligjshëm. Duke marr parasysh edhe theksimet lidhur me detyrat e inspektoratit të punës, i bëjmë me dije gjykatës se vendimi i Gjykatës Kushtetuese numër referent. AGJ 2098/22, dt. 16.12.2022, ka të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 94 të Ligjit të Punës me të cilin nënkuptohet se organet inspektuese apo inspektorati i punës janë organe ekzekutive dhe nuk mund të përvetësojnë organet gjyqësore kështu që në rastet kur ndërhyjnë në të drejtat e garantuara me kushtetutë dhe ligj, Gjykata Kushtetuese ka parapare se shkelen garancitë themelore kushtetuese të përcaktuara në kapitullin II dhe kapitullin VII. Ka theksuar se pala paditëse nuk ka pranuar përgjigje me shkrim lidhur e me ankesën e saj të dt. 12.08.2020, të dorëzuar tek e paditura, po ashtu e njoftoi gjykatën se paditësja nuk ka marr pjesë në konkursin për mësimdhënës të dt. 13.07.2020, meqenëse ka pasur një kontratë të ligjshme dhe të drejtë të marrëdhënies së punës, e që kërkesat dhe ankesat ende duke përfshirë edhe padinë nuk kishin marr një epilog lidhur me këtë marrëdhënie të punës. Kundër vendimit të dt. 03.02.2020, të inspektoratit të punës, paditësja nuk ka parashtruar ankesë me arsyetimin se nuk e ka pranuar dhe nuk ka qene e drejtuar drejt saj drejtpërdrejtë dhe as që është njoftuar lidhur me këtë vendim. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar S.V nga Ferizaj, në riprocedurë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetemi në tërësi në përgjigje në padi si dhe në theksimet në seancat e mëparshme duke kundërshtuar pretendimet e palës paditëse si të pabazuara, njëkohësisht duke kundërshtuar edhe kërkesëpadinë e paditëses si nga baza ashtu edhe nga lartësia, sepse nga të gjitha provat materiale të cilat janë në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës, dispozitave të kontratës kolektive dhe të udhëzimit administrativ që ka të bëjë me normativin e kuadrove arsimor, e gjithë procesi i ndërprerjes së punës dhe hapjes së konkursit është bërë nga palët e treta, ku kanë ushtruar ankesë në inspektoratin e punës ku inspektorati i punës në kuptim të nenit 2, pika a të Ligjit 2002/9, me plotësim ndryshimet e mëvonshme ka bërë mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit të Punës dhe ka konstatuar se paditësja ka themeluar marrëdhënie të punës në kundërshtim me dispozitat ligjore ashtu që drejtoria komunale e arsimit ka qene e detyruar të ndermarre veprime procedurale administrative që kanë të bëjnë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe shpalljen e konkursit. Paditësja ka ushtruar ankesë dhe nuk ka pritur kohen për përgjigje në ankesë dhe ka ushtruar padi, dhe konsiderojmë se padia

është e parakohshme. Paditësja nuk ka ushtruar ankese komisionit komunal për shqyrtimin e kontesteve dhe ankesave pranë Komunës së Ferizajt, gjë që nuk ka shtjerre mjetet e brendshme juridike. DKA, pas konstatimit të gjendjes faktike nga inspektorati i punës së paditësja ka themeluar marrëdhënie të punës në mënyrë të kundërligjshme ka qene e detyruar të shpall konkurs dhe ka shpallur konkurse të cilat janë në shkresë të lende, dhe paditësja nuk ka aplikuar në këtë konkurs. Në konkursin e zhvilluar është zhvilluar procedura e rregullt administrative të institucionit të konkursit, ku ka pasur kandidatë të kualifikuar, është kryer procedura e vlerësimit dhe është zgjedhur kandidati i cili ka plotësuar kushtet. Nga provat materiale që janë në shkresat e lendes vijmë deri tek konkludimi juridik se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, ka administruar këto prova materiale: Konkursi numër 401 i dt.13.07.2020, i shpallur nga e paditura, Ankesa e datës 12.08.2020, drejtuar të paditurës nga paditësja, Kontratë pune për mësimdhënës me numër të protokollit 01 të datës 01.09.2017 e nënshkruar mes palëve ndërgjyqëse, Kontratë pune për mësimdhënës me numër të protokollit 77 të datës 22.09.2016 e nënshkruar mes palëve ndërgjyqëse, Vendimi me numër 43/2020 i dt 03.02.2020, lëshuar nga Inspektorati i punës në Ferizaj, Vendimi i Inspektoratit të punës me numër 294/2020 i datës 13.05.2020, Kontratë pune për mësimdhënës me numër të protokollit 271/2 i datës 01.10.2019, e nënshkruar mes palëve ndërgjyqësve, Njoftim për kandidatet e pranuar për mësimdhënës me numër 14 i datës 06.01.2016 i bërë nga e paditura, Licencë e mësimdhënësit me numër 1027324 lëshuar nga MASHT, Vërtetim për statusin e studentit me numër 856 i datës 19.03.2014, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Arteve –Prishtinë për paditësen, Vendimi për përvojë pune (i cili nuk ka datë) i lëshuar nga Drejtori i Shkollës-SHFMU/ML “ I.Q” – fsh. P.J për paditësen, Njoftim me numër 344/2 i datës 20.07.2020, lëshuar nga e paditura, Njoftim lidhur me zbatimin e njoftimit numër 43/20 i evidentuar me numër 40/2 i datës 13.07.2020 lëshuar nga e paditura, Konkurs numër 834 i datës 01.12.2016, i shpallur nga e paditura, Vërtetim me numër 455 i datës 16.09.2014 lëshuar nga Shkolla e mesme e ulët “ A.H” për paditësen, Diploma e nivelit bachelor e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Arteve – Prishtinë për paditësen, Diplome e nivelit master Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Arteve, Prishtinë për paditësen, Rekomandimi me numër ...8 i datës 14.07.2020 lëshuar nga Fakulteti i Arteve Universiteti i Prishtinës, Pasqyra e llogarisë e lëshuar nga trusti, Ekspertiza

financiare e përpiluar nga eksperti financiar A.K me dt 01.03.2021, Plotësim Ekspertiza e ekspertit financiar A>K e dt 19.07.2024, Pasqyra e llogarisë së trustit pensional e paditëses e dt 18.07.2024, Konkursi i DKA me numër ...1 i dt 13.07.2020, Vendimi për shpalljen e rezultateve me numër ..3 të dt 27.08.2020 të DKA-së, Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të komisionit të paditurës, Vendimi i MPMS me numër ..4/2020 i dt 06.11.2020, Formulari i vlerësimit të kandidatëve, Njoftim me numër ...9 i dt 18.08.2020, lidhur me ankesën numër 07-.../20 të dt 12.08.2020, të parashtruar nga paditësja, Formulari për ankesë i dt 12.08.2020 i paditëses dhe Regjistri i kërkesave të pranuar për punësim i DKA-së me numër ...1 i dt 13.07.2020.

Jokontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte fakti se paditësja ishte e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse e lëndës art figurativ në SHFMU “I.Q” në fsh. P.J-K.Ferizaj, në periudhën që nga dt. 22.09.2016, konform konkursit të dt. 01.12.2016 me nr. 834, e deri më dt. 13.07.2020.

Kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte dhe mbetet ligjshmëria e njoftimit nr. 344/2 të Drejtoreshës së shkollës Z.S, përmes të cilit njoftohet paditësja se më dt. 13.07.2020 me nr. prot. 401 i është ndërprerë marrëdhënia e punës në SHFMU “I.Q” fsh. P.J-K.Ferizaj. Të lartpërmendurës po me këtë datë i është shpallur vendi i punës.

Gjykata duke vepruar konform vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktvendimin AC.nr.3836/21, të dt. 24.02.2024 të Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 19.06.2024 ka marrë akvendim përmes të cilit lejohet zgjerimi i padisë së paditëses ashtu që tani e tutje si objekt kontesti do të jetë edhe anulimi i njoftimit me numër 344/2, të dt. 20.07.2020 të lëshuar nga Drejtoresha e Shkollës Filllore të Mesme të Ulet “I. Q” P. J.

Me leximin e kontratës nr. prot. ..., dt. 22.09.2016, vërtetohet se paditësja me të paditurën kishin lidhur kontratë pune, për vendin e punës mësimdhënëse lëndor në SHFMU I.Q” P.J-K.Ferizaj, prej dt. 22.09.2016 deri në shqyrtim të konkursit.

Me leximin e kontratës nr. prot. 01, dt. 01.09.2017, vërtetohet se paditësja me të paditurën kishin lidhur kontratë pune, për vendin e punës mësimdhënëse lëndor në SHFMU I.Q” P.J-K.Ferizaj, prej dt. 01.09.2016.

Me leximin e kontratës nr. prot. ...1/2, dt. 01.10.2019, vërtetohet se paditësja me të paditurën kishin lidhur kontratë pune, për vendin e punës mësimdhënës lëndor në SHFMU I .Q” P.J-K.Ferizaj, prej dt. 12.09.2019.

Me leximin e vendimit nr. 43/2020, të dt. 03.02.2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Ferizaj, vërtetohet se I. aprovohet si e bazuar ankesa nr. 1/2020, e dt. 03.01.2020 e parashtruar nga A.H.S... ndaj DKA në Ferizaj., II. obligohet punëdhënësi DKA në Ferizaj që në afat prej 15 ditësh të shpall konkurs publik për mësimdhënës të lëndës edukatë figurative në SH C.Z. në Ferizaj si dhe me përfundimin e vitit shkollor 2019/20 të shpallë konkurs publik për lëndën e edukatës figurative në SHFMU I.Q fsh. P-Komuna e Ferizajt.

Me leximin e vendimit nr. 294/2020, të dt. 13.05.2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Ferizaj, vërtetohet se refuzohet e pabazuar ankesa e palës në produrë K.V-Sh e ushtruar kundër vendimit nr. 43/20, të organit të shkallës së parë të inspektorit të punës, vërtetohet vendimi nr. 43/20 i organit të shkallës së parë të inspektorit të punës.

Me leximin e njoftimit nr. 344/2 të Drejtoreshës së shkollës Z.S, vërtetohet se njoftohet paditësja se më dt. 13.07.2020 me nr. prot. 401 i është ndërprerë marrëdhënia e punës në SHFMU “I.Q” fsh. P.J-K.Ferizaj. Të lartpërmendurës po me këtë datë i është shpallur vendi i punës.

Me leximin e formularit për kërkesë apo ankesë të dt. 12.08.2020 të paditëses, vërtetohet se paditësja ka ushtruar ankesë lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës.

Me leximin e njoftimit lidhur me zbatimin e vendimit nr. 43/20, vërtetohet se Drejtori i Drejtorisë së Arsimit A.Ll e ka njoftuar Inspektoratin e Punës në Ferizaj, Drejtorin e Shkollës “I. Q” fsh. P.J-K.Ferizaj, se duhet të publikohet konkursi dhe duhet drejtorja e shkollës ta njoftoj mësimdhënësen-paditësen e cila është duke punuar në lëndën e lartëcekur, se sipas vendimit nr. 43/20 të IP për publikimin e konkursit në SHFMU I.Q fsh. P.J, për lëndën e edukatës figurative, Drejtorja e Arsimit e njofton Inspektoratin e Punës se është në zbatimin e procedurave sipas vendimit të lartcekur për publikimin e konkursit.

Me leximin e konkursit nr. 401, të dt. 13.07.2020, vërtetohet se e paditura ka publikuar konkurs për mësimdhënës sipas vendimit të organit të shkallës së dytë të inspektoratit të punës nr. 294/2020, të dt. 13.05.2020.

Me leximin e diplomës së lëshuar nga Fakulteti i Arteve-UP “H.P.”, e dt. 24.05.2011, nr. 504, vërtetohet se paditësja ka mbaruar studimet themelore universitare në degën e artit figurativ, drejtimin e dizajnit grafik dhe ka diplomën e dizajnit grafik.

Me leximin e diplomës së lëshuar nga Fakulteti i Arteve-UP “H.P.”, e dt. 17.10.2014, nr. 343, vërtetohet se paditësja ka diplomën e masterit të dizajnit grafik.

Me leximin e licencës nr. 1...4, dt. e lëshimit 09.09.2019, dt. e skadimit 09.09.2024, vërtetohet se paditësja posedon licencë të rregullt, licencë të karrierës.

Me leximin e vërtetimit të dt. 16.12.2014, të SHFMU “A.H” në Ferizaj vërtetohet se paditësja e ka kryer punën praktike lënd art figurativ prej 01.09.2014 deri me 16.12.2014 në SHFMU “A.H në Ferizaj.

Me leximin e rekomandimit të Dekan Prof. Asoc. A.S të Fakultetit të arteve të bukura në UP “H.P.”, të dt. 14.07.2020, vërtetohet se mësime të kualifikuara të drejtimit/specializimit dizajn grafik në fakultetin e arteve – UP, tek të cilët në dokumentacionet e tyre posedojnë: index, certifikatë të notave, vërtetim nga fakulteti i arteve, dëshmi se kanë të dhënë lëndën: Metodikë I, II, metodikë e artit figurativ, janë plotësisht të barabart dhe kompetent për dhënien e lëndës art figurativ në nivelin parauniversitar.

Baza ligjore

Gjykata, deri te vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi erdhi duke zbatuar dispozitat ligjore nga Ligji Nr.03/L-212 i Punës i Kosovës, edhe atë dispozitat nga neni 2, paragrafi 1 dhe 2 i cili përcakton se “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. 2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”; neni 8, paragrafi 1 dhe 2 se “Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi”; në nenin 78, paragrafi 1 të Ligjit të Punës , është paraparë se: “I punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të tij”. Në nenin 78, par. 2 të Ligjit të Punës është paraparë se:

“Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”. Ndërsa në nenin 79 të të njëjtit ligj është paraparë se: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 par.2 i këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente”; Neni 80 i Ligjit të Punës parasheh se: “Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës 1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t’i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. 2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente”

Neni 5.1 i Ligjit të Punës parasheh se: “1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.”

Sipas nenit 2, pika a) të Ligjit për Inspektoratin e Punës parashihet që: “2. Inspektorati i punës: a) Do të mbikqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë”.

Neni 6.4 i Ligjit për Inspektoratin e Punës parasheh që: “Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.”

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata në riprocedurë pas marrjes në konsideratë të gjitha sugjerimeve dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, në bazë të çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK, vendosi si në

dispozitiv të këtij aktgjykimi përkatësisht duke refuzuar kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pabazuar.

Me leximin e vendimit nr. 43/2020, të dt. 03.02.2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Ferizaj, vërtetohet se I. aprovohet si e bazuar ankesa nr. 1/2020, e dt. 03.01.2020 e parashtruar nga A.H-S ndaj DKA në Ferizaj., II. obligohet punëdhënësi DKA në Ferizaj që në afat prej 15 ditësh të shpall konkurs publik për mësimdhënës të lëndës edukatë figurative në SH C.Z në Ferizaj si dhe me përfundimin e vitit shkollor 2019/20 të shpallë konkurs publik për lëndën e edukatës figurative në SHFMU I.Q fsh. P.. Komuna e Ferizajt. Ndërsa në bazë të nenit 6.4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës parashihet që: “Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.” Në pjesën e arsytimit të këtij vendimi, në fq. 2, pasuesi 3 thuhet se: “Pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar nga organi i punësimit si dhe dokumentacionit të bashkëngjitur të palës ankuese u konstatua se: punëdhënësi DKA në Ferizaj ka shpallur konkursin nr. 834 të dt. 01.12.2016 për një mësimdhënëse për edukatë figurative në SHFMU I.Q në P.J dhe është pranuar kandidatja A.S – këtu paditësja me njoftimin nga DKA Ferizaj nr. 14 të dt. 06.01.2017 në kundërshtim me nenet 5, par. 14 të Udhëzimit administrativ të MASHT nr. 06/2015 ku për lëndën në fjalë në bazë të dispozitës së lartëcekur mund të angazhohen mësimdhënës të cilët kanë përfunduar fakultetin e arteve të bukura dega e arteve të bukura, programi pikturë, skulpturë dhe grafikë ndërsa kandidatja e pranuar këtu paditësja ka kualifikim master i dizajnit grafik mirëpo DKA Ferizaj pranimin e kandidatës e arsyeton se në konkursin në fjalë nuk kishte kandidat me kualifikim adekuat dhe për të mos e dëmtuar procesin arsimor pranohet kandidatja me kualifikim të përafërt. Dka Ferizaj ka qenë e obliguar që për pozitën në të cilat janë angazhuar mësimdhënës me kualifikim joadekuat në çdo vit shkollor të shpall konkurs publik për pranimin e mësimdhënësve me kualifikim adekuat që në rastin konkret DKA Ferizaj mësimdhënës në fjalë ja ka ripërtërirë kontratën e punës duke e nënshkruar kontratën e fundit më dt. 01.10.2019 dhe duke mos e caktuar datën e përfundimit të kontratës që në rastin konkret cilësohet si kontratë me kohë të pacaktuar andaj DKA Ferizaj duke bërë shkelje të nenit 4 të Udhëzimit administrativ 10/15 të MASHT për kontratën e punës për mësimdhënës të arsimit parauniversitar ku në bazë të kësaj DKA Ferizaj ka qenë e obliguar që për mësimdhënësit të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me nenin 3 të të njëjtij udhëzim të lidhë kontratë me kohë të caktuar andaj DKA Ferizaj është e obliguar që me përfundimin e procesit mësimor për vitin shkollor 2019/20 të shpallë konkurs publik në bazë të nenit 8, par. 1 dhe 2 të Ligjit të Punës në Kosovë nr. 03/L-212.”. Nga kjo provë konstatohet fakti se paditësja ka qenë e pakualifikuar. Për më tepër vendimi

nr. 43/2020, të dt. 03.02.2020 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Ferizaj, është i vërtetuar në plotëni nga vendimit nr. 294/2020, të dt. 13.05.2020 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Ferizaj.

Kësaj prove gjykata ja fali në tërësi besimin sepse është dokument publik, kurse konform nenit 329.1 të LPK parashihet që: “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”. Për më tepër vendimet e inspektorëve të punës në procedurë administrative janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme. Sipas nenit 6.3 të Ligjit për Inspektoratin e Punës kundër vendimit të Inspektoratit të punës mund të ngritet kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh. Mirëpo në shkresat e lëndës mungon prova materiale përmes të cilës do të vërtetohej se është ngritur kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh, ndaj vendimit nr. 294/2020, të dt. 13.05.2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Ferizaj, i cili e vërteton në plotëni vendimin nr. 43/2020, të dt. 03.02.2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Ferizaj. Sipas nenit 87 të Ligjit për procedurën administrative parashihet që: “Akti administrativ hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij, me përjashtim të rasteve kur ligji ose vetë akti i jep fuqi prapavepruese ose të vonuar.” Sipas nenit 116 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik mes palëve, rezulton që: “116.1. Organi kompetent i administratës publike ekzekuton aktin administrativ që ka nxjerrë, vetëm pasi akti të ketë hyrë në fuqi. 116.2. Organi kompetent i administratës publike ekzekuton detyrimet e parashikuara në aktin administrativ që ka nxjerrë, vetëm në qoftë se ligji shprehimisht ua beson atyre ekzekutimin e akteve.” Nga këto dy vendime të inspektoratit të punës, të shkallës së parë dhe të dytë, rezulton fakti se DKA ka qenë e obliguar që të ja ndërpresë marrëdhënien e punës paditëses dhe të shpallë konkurs, gjë për të cilin edhe e ka njoftuar paditësen, konform njoftimit nr. 344/2, të dt. 20.07.2020. Ndërsa në konkursin me nr. 401, të dt. 13.07.2020 të publikuar, gjykata nuk ka dëshmi në shkresat e lëndës se paditësja ka konkuruar.

Në këtë analizë ligjore gjykata mbështetet në dispozitat e nenit 2.2 të LPK, të cilat përcaktojnë se: “2.2 Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale.”

Në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se paditësja ka konkuruar në konkursin me nr. 401, të dt. 13.07.2020 të publikuar, si dhe nuk ka dëshmi të jetë inicuar ndonjë procedurë gjyqësore e çfarëdo natyre përmes të cilës do të kontestohet ligjshmëria dhe drejtshmëria e këtij konkursi. Andaj po që se gjykata do të mirrte vendim përmes të cilit paditësja do të kthehej në vendin e punës në cilësinë e mësimdhënëses ndërsa duke pas parasysh faktin se konkursi nr. 401, të dt. 13.07.2020 përmes të cilit është zgjedhur mësimdhënës i lëndës art figurativ A.I, me 79.8% të pikëve të fituara (konform vendimit për shpalljen e rezultateve të pranimit sipas konkursit nr. 483, të dt. 27.08.2020 të administruar si provë në këtë procedurë) ndërsa ndaj konkursit nuk është inicuar procedurë gjyqësore qoftë e natyrës civile, administrative, penale etj. do të mund të shkelte të drejtat e fituara të personave të tretë nga ky konkurs publik gjë që mund të përbente shkelje të parimit të sigurisë juridike, i cili parim është i garantuar me kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi. Për këtë arsye duke marrë për bazë konkursin e të paditurës në pozitën mësimdhënëse e lëndës art figurativ, gjykata gjeti se procedura për punësim në pozitën mësimdhënëse e lëndës art figurativ, është realizuar në mënyrë të rregullt, ashtu që të drejtë konkurrimi kanë pasur të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet paraprake të konkursit, për çka, gjykata erdhi në përfundim se të gjithë kandidatët të cilët kanë konkuruar për pozitën e mësimdhënësit, kanë pasur të drejtë të konkurojnë në pozitën përkatëse me të gjitha të drejtat e plota, duke mos përjashtuar këtu as kandidatin e përzgjedhur për pozitën gjegjëse dhe as paditësen e cila konteston njoftimin nr. 344/2 të paditurës. Për këtë gjykatë është mëse e qartë se objekt kontesti në këtë rast civilo-juridik nuk është anulimi i konkursit, gjë që nuk ishte as në procedurën paraprake të zhvilluar para kësaj gjykate, gjë që vërtetohet përmes leximit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin është konsideruar e tërhequr padia e paditëses në raport me anulimin e konkursit, por këto arsyetime gjykata i dha me qëllim të zbardhjes dhe arsyetimit të të gjitha rrethanave të rastit, pa paragjykuar në asnjë formë epilogun e çështjes.

Kërkesa e paditëses që të detyrohet e paditura që ta kthejë në vendin e punës u refuzua si e pabazuar, meqenëse, gjykata nuk ka bazë ligjore dhe nuk ka tagër që të detyroj të paditurën që të njëjtën ta kthejë në vendin e punës, përpos nëse do të vërtetohet se ka pasur diskriminim, përndryshe gjykata është e autorizuar të ekzekutoj vetëm dëmshpërblimin adekuat në të holla për punëmarrësin, nëse do të vërtetohet se të njëjtës iu është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme. Paditësja nuk ka paraqitur ndonjë provë se mospërzgjedhja e saj të jetë bërë për shkaqe të diskriminimit. Gjykata ka bazë ligjore rrjedhimisht është e autorizuar që të kthejë të punësuarin në vendin e tij të punës sipas nenit 80, paragrafit 1, pika 1.2 të Ligjit të

Punës vetëm kur vërtetohet faktin se largimi nga puna është i paligjshëm sipas nenit 5 të Ligjit të Punës, i cili nen i referohet diskriminimit në vendin e punës (sipas Ligjit kundër diskriminimit), e që në rastin konkret nga vlerësimi i gjykatës rezultoi se nuk kemi të bëjmë me ndonjë lloj të diskriminimit në vendin e punës të pësuar nga paditësja. Gjykata konstaton se sipas praktikës së GJEDNJ duhet të ekzistojë “dallimi në trajtim të individëve në situatë të ngjajshme”, i cili “bazohet në veçoritë dalluese” dhe se dallimi në trajtim mundet t’i referohet hedhjes poshtë, refuzimit, përjashtimit, ofrimit të kushteve më pak të favorshme apo shërbimeve më të këqija, mohimit të përzgjedhjes apo mundësisë, konform rastit Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 42184/05, datë 16.03.2010, fq. 61.

Meqenëse gjykata e ka refuzuar kërkesën e paditëses për anulimin e njoftimit të kontestuar, atëherë kërkesa për dëmshpërblim është vetvetiu e pabazuar, në këtë drejtim po ashtu nuk i falet besimi as ekspertizës financiare dhe plotësimi të saj të dt. 19.07.2024 sepse janë irelevante, për faktin se paditësja ka dështuar në të provuarit e kërkesës së saj, meqë barra e provës i ngarkohet asaj, si palë, me kërkesën e të cilës është inicuar ky kontest. Përveç të cekurave më lart, është vlerësim i kësaj gjykate se themelimi i marrëdhënies së punës dhe përcaktimi i kushteve të punës i referohet normave ligjore të karakterit dispozitiv duke i lejuar palëve të drejtën, por pa i cenuar dispozitat ligjore të karakterit imperativ. Gjykata, me rastin e vendosjes kishte parasysh këto dispozita ligjore dhe kërkesat e palës paditëse meqë në procedurën civile gjykata vepron brenda kërkesave të palëve (neni 2.1 i LPK) dhe se kërkesat e tilla palët janë të obliguara që ti provojnë. Andaj, nga të gjitha vlerësimet e lartëcekura, gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës. Andaj, konform nenit 322, par. 1 të LPK, paditësja ka dështuar në argumentimin e pretendimit të saj në këtë drejtim edhe gjykata nuk mund t’ia falë besimin të njëjtës. Gjykata, në rastin konkret, me asnjë provë të cilat janë administruar nuk ka gjetur elemente të diskriminimit në raport me paditësen, andaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Paditësja, edhe pse në kërkesën e saj nuk kishte pretenduar se është diskriminuar, por gjykata lidhur me këtë i referohet nenit 5, par. 3 të Ligjit të Punës në të cilin theksohet se: “nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kritereve të caktuara që kërkohen për atë vend pune”. Po ashtu me nenin 7.1 të LPK është paraparë se “Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht

ceket se “Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji).

Gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në bazë të neneve 450, 452 dhe 463 të LPK-së, pasi që paditësja ka humbur procesin gjyqësor, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar-specifikuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata i pati parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, por disa prej pretendimeve që i cilësoi si irelevante nuk i arsyetoi veç e veç, për shkak se nuk çuan peshë në vendosjen ndryshe të kontestit. Ndërsa neni 6 i KEDNJ kërkon që gjykatat vendase të japin arsye mbi vendimet e tyre si në çështjet civile, ashtu edhe në ato penale. Gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pyetje, por nëse një kërkesë është thelbësore për rezultatet e çështjes, gjykata atëherë duhet që specififikisht t’i trajtojë ato në gjykimin e saj, konform rastit para GJEDNJ, Van de Hurk kundër Holandës, aplikacioni nr. 16034/90, të dt. 19.04.1994, par. 61. Ndërkaq sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ.

Nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2024:073920, më datë 13.08.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në këtë gjykatë dhe i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë.